



**Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në IAL.**

**Viti Akademik 2020-2021**

<b>KREU IV/3</b>		<b>Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit</b>
1.	<b>Kreu IV/3, pika 1</b> Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat e përcaktuara, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja.	<b>01.09.2020 – 18.09.2020</b>
2.	<b>Kreu IV/3, pika 6</b> IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datën e përcaktuar, publikojnë në mjedise të dukshme dhe në faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	<b>23.09.2020</b>
3.	<b>Kreu IV/3, pika 8</b> IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	<b>28.09.2020</b>
4.	<b>Kreu IV/3, pika 9</b> Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.	<b>05.10.2020</b>
5.	<b>Kreu IV/3, pika 10</b> Pas datës së përcaktuar, sekretariteti mësimor në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët e renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.	<b>06.10.2020</b>
6.	<b>Kreu IV/3, pika 11</b> IAL-të brenda datës së përcaktuar, përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.	<b>12.10.2020</b>
7.	<b>Kreu IV/3, pika 13, shkronja "b"</b> Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës së përcaktuar ia komunikon IAL-së.	<b>24.01.2021</b>
8.	<b>Kreu IV/3, pika 13, shkronja "f"</b> IAL-të brenda datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.	<b>15.11.2020</b>